

Lojë, argëtim dhe shumë komunikim

Të nderuara pedagogje! Të nderuar pedagogje!

Fëmijët janë personalitete me etje dhe dëshira për dije. Ata dëshirojnë të (njohin) mësojnë sa më shumë që të jetë e mundur dhe përherë të mësojnë dhe të kuptojnë përsëri diçka të re. Ata çdo ditë hasin me fjalë të reja, me shkronja të çuditshme, histori interesante, këngë dhe vjersha për të qeshur ... me pak fjalë: Ata zbulojnë botën e mrekullueshme të gjuhëve me të gjitha aspektet dhe mundësitë.

... Gjuha

Gjuha është një kompetencë endimtare kyçe në jetën e çdo njeriu. Kushdo që mëson shumë shpejt të përdorë veglën e gjuhës ka shance më të mira në shkollë dhe më vonë në tregun e punës. Por gjuhët nuk janë vetëm vegla pune të dobishme: Ato ndihmojnë fantazinë dhe kreativitetin dhe hapin dyert e kulturave dhe të botës.

... PUMA

Përmes kësaj pllakate ne dëshirojmë të japim disa ide dhe sugjerime, se si ju të krijoni ndërgjegjshëm në formë të gjallë raste për të folur dhe të integroheni në jetën e përditshme të kopshtit të fëmijëve.

... Kopshti i fëmijëve

Si institucioni fillestar për formimin – krahas shtëpisë prindërore – kopshtet e fëmijëve vënë gurin themeltar, që tek fëmijët dhe gjuha e tyre të krijohen pak

nga pak kompetencat e tyre gjuhësore. Me punën e tyre të përkushtuar këto ndihmojnë në mënyrë vendimtare që të mbështesin dhe përkrahin fëmijët tek të kuptuarit dhe të mësuarit.

... Shkolla

Nxënësit/Nxënëset që sapo nisin me shkollën fillore me siguri që nuk janë fillestarë/fillestare në mësim. Fëmijët sjellin me vete në shkollë shumë gjëra nga kopshti i fëmijëve dhe shtëpia. Më pas ata/ato mësojnë me kënaqësi dhe sukses, në rast se dijet dhe mundësitë e tyre do të shihen dhe vlerësohen. Me këtë pllakatë ne u japim fëmijë me vete në rrugën e tyre përveç lojës PUMA edhe një „dokumentit të vogël gjuhes“. Vëzhgimi i përparimeve gjuhësore është tensionues për padagogët/pedagoget dhe prindërit, por mbi të gjitha për vetë fëmijët. Në një vështrim të parë ata shohin: „unë e dija këtë kur isha pesë vjeç. Por tani unë di shumë më tepër.“ Kjo jep një vetëbesim tepër të madh!

... Prindërit

Do të ishte mirë, nëse ju prindër do të ishit të vëmendshëm lidhur me këtë pllakatë dhe të viheshit në lëvizje, që së bashku me fëmijët të mbushnit ato faqe të parashikuara për të dhe të luani në shtëpi lojën e PUMA-s. Faleminderit!

Ne u urojmë juve dhe fëmijëve kënaqësi të madhe gjatë lojës dhe bashkëbisedimit!

A TË KUJTOHET TY MË KOHA E DIKURSHME NË KOPËSH TIN E FËMIJËVE ...

Unë quhem	Ja ku jam unë (me ____ vjeç):
Emri im nënkupton	
Prindërit e mi e kanë zgjedhur për mua këtë emër, mbasi	

Unë e di që në botë ka shumë gjuhë. Unë di këto gjuhë:

Në shtëpi unë flas	Në kopshtin e fëmijëve unë flas

Kam dëshirë të madhe të mësoj ..., mbasi ...

Fjala ime më e dashur është ..., mbasi ...

Libri im më i dashur është ..., mbasi ...

Loja ime më e dashur është ..., mbasi ...

Kujtimet janë diçka personale dhe çdo njeri i ruan ndryshe në zemrën e tij përshypjet dhe përjetime7. Pllaka-ta PUMA duhet të jetë një kujtim i qëndrueshëm të fëmijët për kohën e kopshtit. Prandaj ne kemi përgatitur disa faqe në atë mënyrë, që secili fëmijë të zhvillohet individualisht me fjalët dhe vizatimet e tij.

Për këtë fëmijëve u nevojiten referentë/referente, të cilët do t'i mbështesin ata në përgatitjen e faqeve të pllakatës dhe që do të marrin kohë, që të bisedojnë me ta lidhur me përjetimet, pasionet e veçanta dhe interesat e tyre.

Së shpejti unë do të shkoj në shkollë!

Një sy i qeshur dhe një sy i përlotur ... Kështu do të përshkruhen shpesh kalimet në një etapë tjetër të jetës. Edhe tek fëmijët, të cilët shkojnë në shkollë, nuk ndodh ndryshe: Ata mezi presin diçka të re dhe njëkohësisht ndahen nga njerëzit dhe vendet që kanë fituar dashuri. Ndjenjat dhe shqetësimet, pritja me gëzim, por edhe frika, janë gjërat më normale në botë për këtë fazë. Çfarë mund të bëjmë ne, në mënyrë që fëmijët të fillojnë ditën e parë të shkollës me dy sy të qeshur? Të marrim kohë, të dëgjojmë... dhe të flasim shumë me njëri-tjetrin!

Të forcohet përgatitja & vetëbesimi

Shpesh e panjohura na frikëson. Prandaj përgatitja e mirë u lehtëson së tepërmi fëmijëve hapin për në etapën e re të jetës. Përgatitje e mirë nuk mendohet, që fëmija duhet të ushtrojë leximin, shkrimin dhe llogaritjen tashmë që përpara hyrjes në shkollë – por përkundrazi bëhet fjalë për atë, që fëmijët të forcojnë pavarësinë dhe vetëbesimin e tyre.

„Çfarë do të mësoj unë në shkollë?“ „A do të gjej shokë të rinj?“ „Si do të jetë mësuesja/ mësuesi?“ „Si është klasa?“. Me të gjitha këto pyetje merren fëmijët dhe atyre u vjen mirë të flasin lidhur me to.

Hyrja në shkollë nuk është startimi nga zeroja – ky është një kalim

Të dyja institucionet punojnë shumë ngushtë me njëra-tjetrën, në mënyrë që kalimi nga kopshti i fëmijëve për në shkollë të funksionojë më mire. Në këtë mënyrë pedagogët/pedagoget dine më shumë për njëri-tjetrin dhe mund të harmonizojnë jetën e përditshme në kopësht dhe shkollë edhe me mësimin gjuhësor.

Fëmijët janë të ndryshëm dhe në mësimin e gjuhëve ata ndjekin rrugën e tyre ...

... ndonjëherë kjo ndoshta mund të jetë ndonjë rrugë e tërthortë, por ajo që ka rëndësi është, që ata në fund të arrijnë qëllimin!

Njerëzit bashkohen me njëri-tjetrin duke biseduar ...

... kjo vlen gjithashtu edhe për fëmijët, pedagogët/pedagoget dhe prindërit. Pra: Shpalos pllakatën dhe shko përpara!

UNË KAM MËSUAR SHUMË NË KOPSHTIN E FËMIJËVE/ UNË JAM NË GUËNDJE ...


☐		të tregoj, se çfarë kam përjetuar dhe kam parë.	☐		të përshëndes, të falenderoj dhe të lutem për diçka.
☐		të njoh dhe të përmend disa shkronja.	☐		të shoh me ëndje libra me figura dhe të tregoj histori.
☐		të flas disa fjalë në gjuhë të ndryshme.	☐		të recitoj vjersha.
☐		të tregoj, se si jam me shëndet.	☐		të demonstroj duke përplasur duart rrokjet e emrit tim apo të fjalëve të tjera.
☐		të bëj pyetje të thjeshta dhe të jap përgjigje.	☐		të futem në role të tjera dhe të luaj pjesë teatrale.
☐		të tregoj diçka lidhur me mua dhe familjen time.	☐		të këndoj këngë.
☐		të them, se çfarë më duhet, dhe se çfarë kam qejf dhe çfarë nuk kam qejf.	☐		të përsëris fjalë, të cilat mua më parë m'i ka thënë dikush tjetër.

Kjo faqe duhet të inkurajojë fëmijët, që të shpjegojnë me njohuritë e tyre të gjuhës. Vetëvlerësimi dhe njohja e anëve të forta të personalitetit janë kompetenca të rëndësishme. të cilat na shoqërojnë neve gjatë gjithë jetës dhe që janë tepër të rëndësishme në shkollë dhe në tregun e punës. Pra asnjëherë nuk quhet herët për të filluar me stërvijen e këtyre aftësive.

Fëmijët janë krenarë, në rast se atyre do t'u lejohej të tregonin, se sa shumë dinë. Në këtë mënyrë ata krijojnë krejt automatikisht vetëbesimin dhe vetëdijen dhe kanë mundësi që t'i afrohen ditës së parë të shkollës me gëzim, bindje dhe kureshtje. Dhe kush e di, ndoshta ata do të kenë dëshirë, që pllakatën ta marrin me vete ditën e regjistrimit në shkollë apo që atë tua tregojnë mësuesit/mësueses në ditën e parë të shkollës.

Me qëllim që përparësitë gjuhësore të bëhen të dukshme dhe të dokumentohen, ne i kemi dhënë përparësi një rrethi, i cili duhet të ngjyroset me larmi ngjyrash, në rast se fëmija ka përshypjen, se ai tashmë është në gjendje për aktivitetin e cituar.

UNË E KRIJOOJ BOTËN TIME ME NGJYRA DHE TË TREGOJ TY PËR ATË!



Çdo fëmijë mund ta krijojë këtë faqe thjesht me dëshirë sipas qejfit: Ka vend për një fotografi me të gjithë grupin e kopshtit të fëmijëve, një shenjë dore, një vizatim dhe për shumë gjëra të tjera. Fantazive nuk mund t'u vihet kufi! Në rast se puna kreative do të zhvillohet në dialog, atëherë kjo do të ishte okoma më mirë.

OSZ Österreichisches Sprachen-Kompetenz-Zentrum
Wo Qualität zur Sprache kommt!

Medieninhaber und Herausgeber
Österreichisches Sprachen-Kompetenz-Zentrum
8010 Graz, Hans-Sachs-Gasse 3/I
www.oesz.at

Bundesministerium Bildung

Im Auftrag des
Bundesministeriums für Bildung
1010 Wien, Minoritenplatz 5
www.bmb.gv.at

Idee, Konzeption und Umsetzung der PUMA-Materialien:
Karin Weitzer, ÖSZ

Illustrationen:

Eric Chen

Design & Layout:

Max Werschitz, Kontraproduktion
Gruber & Werschitz OG

Ein besonderer Dank gilt Gabriele Bäck (Charlotte Bühler Institut für praxisorientierte Kleinkindforschung), Katrin Zell (MA 10 – Wiener Kindergarten/Referat „Sprachliche Bildung“ und den zahlreichen Critical Friends, die das Projekt durch ihr wertvolles Feedback bereichert haben.

Weitere Materialien und Hintergrundinformationen:

www.oesz.at/puma

www.schule-mehrsprachig.at

www.charlotte-buehler-institut.at

www.literacy.at

https://elementarpedagogik.schule.at

Alle Rechte vorbehalten. © Österreichisches Sprachen-Kompetenz-Zentrum 2025.
Letzter Zugriff auf die angegebenen Links: 15.9.2025.

oesz.at



oesz.at/puma

OSZ Österreichisches Sprachen-Kompetenz-Zentrum

oesz.at

Bundesministerium Bildung

Albanisch

PUMA – Gjuhët e mia

Loja PUMA krijon raste të gjuhës pavarësisht nga gjuha fillestare e fëmijëve, me qëllim për të mbështetur

- gëzimin në tregim, këngë dhe bisedim
- vetëbesimin gjatë të folurit
- njohjen e gjuhëve të tjera
- solidaritetin.

Qëllimi i kësaj loje kooperative, është që të gjithë bashkëluajtësit/bashkëluajtëset si ekip të mbushin së bashku kutinë e thesarit mundësisht me shumë thesarë gjuhësorë.

Bashkëluajtësit/Bashkëluajtëset

- maksimalisht 4 fëmijë
- e përshtatshme për fëmijë, për të cilët detyrat e fushave të PUMA-s janë sfiduese dhe të menaxhueshme.

Pajisja

- 1 një kub me 3 apo 6 sy
- Figurë loje për çdo bashkëluajtës/bashkëluajtëse
- Thesarë gjuhësorë në formën e materialit grumbullues (p.sh. perla, guacka, gurë të vegjël) për të nëmëruar detyrat e përmbushura të fëmijëve
- Kutia e thesarit (psh. karton, kuti druri) për grumbullimin e thesareve gjuhësorë të fituara bashkërisht në lojë

Fushat e thesareve

- Për secilën fushë thesari Puma i jep çdo fëmijë një detyrë, të cilën ai duhet t'a realizojë në gjuhën e tij.
- Në rast se fëmija nuk dëshiron ta kryejë menjëherë detyrën, atëherë atij i jepet ky shans rradhën tjetër.
- Në rast se një fushë thesari është e zënë me një figurë, atëherë vendosen figurat personale dhe realizohet detyra.
- Për çdo detyrë të kryer ka një thesar gjuhe, i cili do të vendoset në kutinë e përbashkët të thesarit.
- Në vend të detyrave të përshkruara mund të mendohen detyra të tjera të përshtatshme.

Fusha të tjera

- Fushat në ngjyrë portokalli janë fushat e lojës drejt rrugës së qëllimit.
- Fusha në ngjyrë blu: Figura e lojës kapërcen përpara fushës së thesarit që ndodhet pranë.
- Fusha në ngjyrë jeshile: Figura e lojës kapërcen mbrapa fushës së thesarit që ndodhet pranë.

STARTI fillon tek „Gjuha është STARTI“

- Vendosni figurat e lojës në fushën e startit
- Bini dakort, se kush duhet të fillojë i pari
- Hidhni kubin sipas rradhës dhe kaloni më tej
- Plotësoni detyrat në fushat e thesarit

FUNDI është tek „Gjuha është QËLLIMI“

- Në rast se të gjitha figurat arrijnë tek qëllimi, atëherë loja përfundon.
- Tashmë kutia e thesarit boshatiset dhe nëmërohen thesarët e fituar në lojë.

GJUHA ËSHTË E NEVOJSHME ...

Merr një send dhe
përshkruaj, se çfarë
ndjesie ke në prekje!

MATERIALI & MEDIA

Fëmijët e
„kuptojnë“
botën.

Merr katër lapsa me
ngjyra. Çfarë ngjyre
kanë ata? Cila është
ngjyra jote më e
dashur?

LARMIA

Gjërat e përbashkëta dhe të
veçanta e bëjnë jetën të larmishme.

SHËMBULL

Fëmijës dëgjojnë
gjithçka dhe më pas
imitojnë shumë.

Shpik një
fjalë për të
qeshur, që
nuk ekziston!

SINGERITETI & KREATIVITETI

Fëmijët kanë me mijëra
mënyra të shprehuri.

Këndo ose
duartrokite këngën
tënde më të dashur!

MUZIK & RRIËM

Fëmijët e „kuptojnë“
botën.

Gjuha është
STARTI
dhe gjuha është
QËLLIMI

EMOCIONALITETI

Unë shprehem ashtu siç ndihem.

Ku e dallon
ti,që dikush
është i
mërzitur apo
i gëzuar?

VETËDIJA & VËMENDJA

Të eksplorohet bota me shqisa të mprehta.

Si quhet ushqimi yt më
i dashur dhe si shijon
ai?

SHKRIM E KËNDIM

Shkronjat dhe librat hapin botë të reja.

Cili është libri yt më i
dashur dhe përse ti e ke
atë kaq për zemër?

E PËRDITSHMJA

Atë çka thonë fëmijët çdo
ditë nuk të sjell mundim.

Si mund të
përsëritësh
ti dikë?

Si quhen prindërit dhe
shoqet/shokët e tu?

SHOQËRITË & FAMILJA

Bashkërisht do të arrijmë qëllimin.

LËVIZJA

Me vrell, dinamikë, hov drejt
frymëzimit të gjuhëve.

Në botë ka shumë gjuhë dhe shkrime:

„Po“ për shëmbull mund të thuhet:

- ① ji hân (gjuhë urdu) ② ne (greqishte e re) ③ da (rusisht)
④ na'am (arabisht) ⑤ shi (kinezçe)